


Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIET E UJIT
REGULATORNI AVTORITETI ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



31. 12. 2018

Në mbështetje të nenit 19, paragrafin 1, të Ligjit Nr. 05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 4/2016, datë 14. 01. 2016, dhe konform nenit 15 të Rregullores së ARRU Nr. 07/2016 për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimit të Ujit në Kosovë, datë 23 Shtator 2016, si dhe rezultatet finale nga kalkulimet, përmes aplikacionit tarifor të DT, për tarifat gjegjëse të shërbimeve, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, merr këtë:

V E N D I M

për miratimin e urdhëresës së tarifave të shërbimeve (UTSH)

1. Miratohet Urdhëresa Tarifore e Shërbimeve (UTSH) e KRU "Mitrovica" sh.a Mitrovicë (ARRU/UTSH-11/04/2019), për aktivitetet themelore të shërbimeve të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe ujit të trajtuar me shumicë.
2. Lartësia e tarifave përfshinë vetëm vlerën faturale (përfshihet TVSH), për shërbimet themelore.
3. ARRU mund të bëjë korrigjime të jashtëzakonshme të UTSH, me kërkesë të KRU "Mitrovica" sh. a, në përputhje me nenin 47 të Ligjit Nr. 05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe në pajtim me nenin 16 dhe 17 të Rregullores 07/2016 Për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimit të Ujit në Kosovë.
4. KRU "Mitrovica" sh. a. duhet të shpërndajë Listën e Tarifave të Shërbimit të aprovuara me këtë UTSH, tek secili Konsumator, në momentin e nënshkrimit të Kontratës për Shërbime ose së paku një herë në fillim të aplikimit të saj t'i bashkëngjis të njëjtën, faturës të konsumatorëve.
5. Lista e Tarifave për Shërbime, e aprovuar nga ARRU me këtë UTSH, duhet të publikohet nga KRU "Mitrovica" sh. a., së paku në njëërën prej gazetave ditore me tirazh gjithë përfshirës në tërë Kosovën, brenda shtatë (7) ditëve të punës, pas shpalljes dhe publikimit të saj nga ARRU webfaqen; www.arru-rks.org.
6. Kjo UTSH publikohet në tre (3) gjuhë, dy nga të cilat janë zyrtare në Kosovë dhe në Gjuhën Angleze. Në rast mospërputhje në mes të versioneve (për gjuhët e përdorura) të UTSH-ës, do të mbizotërojnë versioni i shkruar në gjuhën Shqipe.
7. UTSH, hyn në fuqi më 1 janar 2019 dhe se vlen vetëm për vitin fiskal 2019 (01.01-31.12.2019).

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në Komisionin Shqyrtues, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi me shkrim.

Dërguar:

1 x 1 Arkivit të ARRU

1 x 1 Kryeshefit Ekzekutiv të KRU-së

Raif Preteni
Drejtor i ARRU



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI TË RRREGULLIMIT PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORY AUTHORITY FOR WATER SERVICES
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



ARRU/UTSH-11/04/2019

URDHËRESË TARIFORE E SHËRBIMEVE

KRU "MITROVICA" SH.A MITROVICË PËR VITIN 2019

2019.04.04
P. P.

1. Tarifat fikse dhe Tarifat volumetrike për aktivitetet themelore të ofrimit të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura

Kategoria e Konsumatorëve	Tarifa Fikse (EUR/muaj)	Tarifa Volumetrike për Shërbimet e ujësjellësit (EUR/m ³)	Tarifa Volumetrike për Shërbimet e ujërave të ndotura (EUR/m ³)
Shtëpiak	1	0.36	0.09
Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	2	0.64	0.20

2. Tarifa volumetrike për aktivitetet themelore të ofrimit të shërbimeve të ujit me shumicë

Kategoria e Konsumatorëve	Tarifa Volumetrike për Shërbimet e ujit me shumicë (EUR/m ³)
Ofrues i shërbimeve: KRU "Mitrovica" sh.a Mitrovicë	0.17

KRU "Mitrovica" sh.a Mitrovicë është e obliguar të bëjë nënshkrimin e kontratës me pranuesin e shërbimit të ujit të përpunuar me shumicë.

3. Tarifat për aktivitetet themelore të lidhjes së konsumatorëve në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit

3.1 Tarifa për inspektimin e lidhjes së re në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit

Kategoria e Konsumatorëve	Diametri i gypit të lidhjes	Tarifa për ujësjellës dhe kanalizim (EUR)
Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarës /grumbullues dhe ujëmatësve	10.00

Shënim:

1. Pasi që kjo tarifë përfshinë kryesisht shpenzime fikse, atëherë e njëjta shumë (dmth 10 EUR) do të paguhet kur inspektimi: (i) për lidhjet në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit, kur ekzistojnë të dyja bashkë; dhe (ii) kur ekziston kërkesa vetëm për njërin shërbim.
2. Kjo tarifë nuk aplikohet kur lidhja e re realizohet nga Kompania, me ç'rast duhet të aplikohet vetëm tarifa: "Tarifat për realizimin fizik të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit".
3. Kjo tarifë nuk aplikohet në rastet kur lidhja e re realizohet nga kompanitë e autorizuar përmes donacioneve, pasi që tërë projekti (përfshirë edhe lidhjet) i nënshtrohen pranimit teknik.

3.2 Tarifat për realizmin fizik të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit

Kategoria e Konsumatorëve	Diametri i gypit të lidhjes	Tarifa e lidhjes (pa pusëtë)* (EUR)	Tarifa e lidhjes (me pusëtë, pa asfaltim)** (EUR)	Tarifa totale (lidhja, pusëta, asfaltimi)*** (EUR)
Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	15 mm	80.00	240.00	490.00
	20 mm	80.00	240.00	490.00
	25 mm	100.00	260.00	510.00
	32 mm	140.00	300.00	550.00
	40 mm	180.00	340.00	590.00
	50 mm	370.00	530.00	780.00
	65 & 75 mm	490.00	650.00	900.00
	80 mm	625.00	785.00	1,035.00
	100 mm	780.00	940.00	1,190.00

Shënim:

*Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh vetëm realizimin e lidhjes (pa përfshirë ndërtimin e pusëtës)

**Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh realizimin e lidhjes dhe ndërtimin e pusëtës, ndërsa nuk ka kërkesë për asfaltim

***Aplikohet në rastet kur gypi i shërbimit gjendet në rrugë apo trotuar kur Kompania pas punimeve është e obliguar të e kthej rrugën apo trotuarin në gjendjen e mëparshme.

3.3 Tarifat për realizmin fizik të lidhjes në rrjetin e kanalizimit

Kategoria e Konsumatorëve	Diametri i gypit të lidhjes	Tarifa e lidhjes (pa pusëtë)* (EUR)	Tarifa e lidhjes (me pusëtë, pa asfaltim)** (EUR)	Tarifa totale (lidhja, pusëta, asfaltimi)*** (EUR)
Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	160 mm	26.00	153.00	403.00
	200 mm	36.00	163.00	413.00
	250 mm	46.00	173.00	423.00
	315 mm	76.00	203.00	453.00

Shënim:

*Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh vetëm realizimin e lidhjes (pa përfshirë ndërtimin e pusëtës)

**Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh realizimin e lidhjes dhe ndërtimin e pusëtës, ndërsa nuk ka kërkesë për asfaltim

***Aplikohet në rastet kur pusëta gjendet në rrugë apo trotuar kur Kompania pas punimeve është e obliguar të e kthej rrugën apo trotuarin në gjendjen e mëparshme.

3.4 Tarifa për ndërprerjen e përkohshme të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit

Kategoria e Konsumatorëve	Diametri i gypit të lidhjes	Tarifa për ujësjellës dhe kanalizim (EUR)
Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarës /grumbullues dhe ujëmatësve	10.00

3.5 Tarifa për ndërprerjen e përhershme të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit

Kategoria e Konsumatorëve	Diametri i gypit të lidhjes	Tarifa për ujësjellës dhe kanalizim (EUR)
Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarës /grumbullues dhe ujëmatësve	20.00

3.6 Tarifa për ri-lidhje në rrjetin e ujësjellësit (pas ndërprerjes së përkohshme)

Kategoria e Konsumatorëve	Diametri i gypit të lidhjes	Tarifa për ujësjellës dhe kanalizim (EUR)
Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarës /grumbullues dhe ujëmatësve	10.00

4. Tarifat për aktivitetet tjera themelore të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura

4.1. Testimi i ujëmatësit për siguri të matjes

Kategoria e Konsumatorëve	Diametri i ujëmatësit	Tarifa për ujësjellës (EUR)
Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional)	20 mm	16.50
	25 mm	16.50
	32 mm	16.50
	40 mm	18.00
	50 mm	18.00
	63 mm	18.00
	75 mm	19.00
	90 mm	19.00
	110 mm	19.00

Shënim: Kjo tarifë aplikohet konform nenit 33 të Rregullores 02/2016 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë.